LIGJ
Nr. 61/2015

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EVROPIAN PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E UNIONIT "KONKURRENCA E NDËRMARRJEVE DHE NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME (COSME) 2014-2020"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e unionit "Konkurrenca e ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (COSME) 2014-2020", sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 11.6.2015

Shpallur me dekretin nr. 9145, datë 23.6.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE

NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EVROPIAN MBI PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E UNIONIT KONKURRENCA E NDËRMARRJEVE DHE NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME (COSME) (2014 - 2020)

Qeveria e Republikës së Shqipërisë, referuar më poshtë si Shqipëria, nga njëra anë, dhe Komisioni Evropian, i referuar më poshtë si "Komisioni", në emër të Bashkimit Evropian,

Duke pasur parasysh se:

1. Një Marrëveshje Kuadër është nënshkruar më 22 nëntor 2004, Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë, e cila përcakton parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë[1] në programet e Unionit. Neni 5 i Marrëveshjes Kuadër parashikon se termat dhe kushtet specifikë, duke përfshirë kontributin financiar në lidhje me pjesëmarrjen e Shqipërisë në secilin Program të veçantë, do të përcaktohen nga Komisioni dhe Qeveria e Shqipërisë;

2. Programi për Konkurrencën e Ndër-marrjeve dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME) është krijuar me Rregulloren (BE) nr. 1287/2013, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit,

[1] FZ L 192, 22.7.2005, f. 2.

të datës 11 dhjetor 2013[2];

3. Sipas nenit 6/b të Rregullores (BE) nr. 1287/2013, vendet aderuese, vendet kandidate dhe kandidatët potencialë mund të marrin pjesë në përputhje me parimet e përgjithshme dhe termat dhe kushtet e përgjithshëm për pjesëmarrjen e atyre vendeve në programet e Unionit të krijuara në Marrëveshjet përkatëse Kuadër dhe vendimet e Këshillit të Shoqatës ose marrëveshjeve të ngjashme;

4. Organet e vendosura në Shqipëri do të kenë të drejtën të marrin pjesë në aktivitetet periodike, të cilat duhet të fillojnë para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Si rrjedhojë, kostot e shpenzuara për këto aktivitete, zbatimi i të cilave fillon më 2014, do të konsiderohen të pranueshme sipas të njëjtave kushteve si ato që zbatohen për kostot e shpenzuara nga organet e vendosura në shtetet anëtare, me kusht që kjo marrëveshje të hyjë në fuqi para përfundimit të veprimit në fjalë,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Programi

Shqipëria do të marrë pjesë në Programin për Konkurrencën e Ndërmarrjeve dhe Ndër-marrjeve të Vogla dhe të Mesme (referuar më poshtë si "Programi"), në përputhje me kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen Kuadër të datës 22 nëntor 2004, ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë, mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programet e Unionit, dhe sipas termave dhe kushteve të përmendur në këtë Marrëveshje.

Neni 2

Termat dhe kushtet në lidhje me pjesëmarrjen në Program

1. Shqipëria do të marrë pjesë në aktivitetet e Programit në përputhje me objektivat, kriteret, procedurat dhe afatet e përcaktuar në Rregulloren (BE) nr. 1287/2013 dhe si më poshtë:

2. Termat dhe kushtet e zbatueshëm për paraqitjen, vlerësimin dhe përzgjedhjen e aplikimeve dhe për zbatimin e veprimeve nga institucionet e ligjshme, organizatat dhe individët e pranueshëm të Shqipërisë do të jenë të njëjtë me ata të zbatuara për institucionet, organizatat dhe individët e pranueshëm të shteteve anëtare.

3. Për të marrë pjesë në Program, Shqipëria do të paguajë çdo vit një kontribut financiar për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian në përputhje me nenin 3 më poshtë.

4. Kontributi financiar i Shqipërisë në lidhje me pjesëmarrjen e saj dhe zbatimin e programit do t'i shtohet shumës së rezervuar çdo vit në Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian për kostot totale të autorizuara të detyrimeve të pranueshme, në mënyrë që të përmbushen detyrimet financiare që rrjedhin nga forma të ndryshme të masave të nevojshme për ekzekutimin, menaxhimin dhe operimin e programit.

5. Një nga gjuhët zyrtare të BE-së, në këtë rast gjuha angleze, do të përdoret për procedurat në lidhje me kërkesat, kontratat dhe raportet, si dhe për aspekte të tjera administrative të Programit.

Neni 3

Kontributi financiar

Rregullat që rregullojnë kontributin financiar të Shqipërisë përcaktohen në shtojcën I.

Neni 4

Raportimi dhe vlerësimi

Pa cenuar përgjegjësitë e Komisionit dhe të Gjykatës Evropiane të Auditëve në lidhje me monitorimin dhe me vlerësimin e programit, pjesëmarrja e Shqipërisë në Program do të monitorohet vazhdimisht mbi

[2] FZ L 347, 20.12.2012, f. 33.

bazën e një partneriteti ndërmjet Komisionit dhe Shqipërisë. Shqipëria do t'i dërgojë Komisionit raportet përkatëse dhe do të marrë pjesë në aktivitete të tjera specifike të parashikuara nga BE-ja në këtë kontekst.

Raportimi dhe vlerësimi do të kryhen në përputhje me rregullat e përcaktuara në shtojcën II.

Neni 5

Dispozita të fundit

1. Kjo Marrëveshje do të zbatohet për kohëzgjatjen e Programit, duke filluar nga 1 janari 2014. Megjithatë, nëse Bashkimi Evropian vendos të zgjasë kohëzgjatjen pa ndonjë ndryshim thelbësor brenda Programit, kjo Marrëveshje do të zgjatet përkatësisht dhe automatikisht nëse asnjëra palë nuk e kundërshton brenda një muaji pas vendimit të zgjatjes së afatit.

2. Kjo Marrëveshje mund të përfundohet nga Palët në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së Programit me një njoftim me shkrim, me anë të të cilit informon mbi qëllimin për të përfunduar pjesëmarrjen në Program. Në bazë të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, përfundimi do të hyjë në fuqi tre muaj kalendarikë pas datës kur njoftimi me shkrim arrin te marrësi.

3. Projektet dhe aktivitetet në proces në kohën e përfundimit do të vazhdojnë deri në përfundimin e tyre sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, si dhe marrëveshjeve kontraktuale që zbatohen për këto projekte dhe aktivitete dhe dispozitave të shtojcës II.

4. Shtojcat formojnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

5. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me shkrim me pëlqimin e ndërsjellë të palëve.

Neni 6

Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën në të cilën Shqipëria njofton Komisionin nëpërmjet kanaleve diplomatike se ratifikimi i saj i brendshëm ka përfunduar.

Bërë në Tiranë, më 3 mars 2015.

Për Republikën e Shqipërisë:
Në emër të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë
Z. Arben Ahmetaj
Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Për Komisionin Evropian:
Në emër të Bashkimit Evropian
Znj. Elzbieta Bienkowska
Komisioneri Evropian për Tregun e Brendshëm, Industrinë, Sipërmarrjen dhe SME-të

SHTOJCA I

RREGULLAT QË RREGULLOJNË KONTRIBUTIN FINANCIAR TË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E UNIONIT "KONKURRENCA E NDËRMARRJEVE DHE NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME (COSME)"

1. Llogaritja e kontributit financiar të Shqipërisë

1) Kontributi financiar për t'u paguar nga Shqipëria për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian për të marrë pjesë në Program do të vendoset në raport me shpërndarjen vjetore në Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian për kostot totale të autorizuara të detyrimeve të pranueshme të

nevojshme për zbatimin, menaxhimin dhe operimin e Programit.

2) Kontributi financiar do të llogaritet duke aplikuar faktorin e proporcionalitetit me buxhetin mesatar vjetor të Programit.

3) Faktori i proporcionalitetit që rregullon kontributin e Shqipërisë është marrë nga vendosja e një raporti ndërmjet produktit të brendshëm bruto të Shqipërisë me çmimet e tregut, dhe shuma e produkteve të brendshme bruto, me çmimet e tregut të Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë.

(GDP me çmimet e tregut për Shqipërinë) /(GDP me çmimet e tregut për BE-në 28+ Shqipëria) = faktori i proporcionalitetit. (Faktori i proporcionalitetit) x buxheti mesatar vjetor i Programit = kontributi financiar i Shqipërisë për COSME-n. Buxheti mesatar vjetor = buxheti shumëvjeçar i miratuar me Rregulloren (BE) nr. 1287/2013 (2298.243 mil € / 7 = (328.32 mil €).

4. Ky raport është llogaritur mbi bazën e të dhënave të fundit statistikore që i përkasin të njëjtit vit nga Zyra Statistikore e Komuniteteve Evropiane (Eurostat), në dispozicion në kohën e negocimit të kësaj Marrëveshjeje.

5. Kjo shtojcë përfshin shumat fikse për katër vitet e para të zbatimit të Programit (2014 - 2017).

6. Për pjesën e mbetur të Programit (2018 - 2020), kontributi financiar vjetor do të llogaritet gjatë vitit 2017, duke përdorur të njëjtën formulë, duke marrë parasysh të dhënat e fundit statistikore dhe çdo ndryshim në buxhetin total të Programit.

7. Kontributet financiare vjetore për t'u paguar nga Shqipëria për buxhetin e Bashkimit Evropian për të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e Programit për periudhën 2014 - 2017 do të jenë si më poshtë: € 235.838.

8. Kontributi i Shqipërisë do të mbulojë kostot e lidhura me zhvillimin dhe ekzekutimin e veprimeve të parashikuara në Program.

9. Kostot e udhëtimit dhe kostot e jetesës të shkaktuara nga përfaqësuesit dhe ekspertët e Shqipërisë për qëllime të marrjes pjesë si vëzhgues në punën e Komitetit të përmendur në nenin 21 të Rregullores (BE) 1287/2013 që krijon Konkurrencën e Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME) (Komiteti i Menaxhimit të COSME-s), ose takime të tjera në lidhje me zbatimin e Programit do të rimbursohen nga Komisioni mbi të njëjtën bazë dhe në përputhje me procedurat aktualisht në fuqi për përfaqësuesit e Shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

10. Rregullorja Financiare e zbatueshme për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian do të zbatohet për menaxhimin e kontributit të Shqipërisë.

2. Pagesa e kontributit financiar të Shqipërisë

1) Pasi kjo Marrëveshje të jetë ratifikuar dhe në fillim të çdo viti vijues buxhetor, Komisioni do t'i dërgojë Shqipërisë një thirrje për fondet që i korrespondojnë kontributit të saj për kostot e mbuluara nga kjo Marrëveshje.

2) Ky kontribut do të paguhet në euro në një llogari bankare të Komisionit të caktuara në euro.

3) Shqipëria do të paguajë kontributin e saj për kostot vjetore në përputhje me thirrjen për fonde jo më vonë se tre muaj pas datës së thirrjes. Çdo vonesë në pagesën e kontributit do të shkaktojë pagesën e interesit të munguar nga Shqipëria mbi shumën e papaguar që nga data e caktuar. Norma e interesit do të jetë norma e zbatuar nga Banka Qendrore Evropiane për operacionet e saj kryesore të rifinancimit, siç publikohet në seritë C të Fletores Zyrtare të Bashkimit Evropian, në fuqi në ditën e parë kalendarike të muajit në të cilin bie afati, rritur me 3.5 pikë për qind.

Në rast se vonesa në pagesën e kontributit është e tillë që mund të rrezikojë seriozisht zbatimin dhe menaxhimin e Programit dhe në rast mospagese 20 ditë pune pas një letre zyrtare kujtese të dërguar nga Komisioni për Shqipërinë, pjesëmarrja e Shqipërisë në Program për vitin përkatës do të pezullohet.

SHTOJCA II

KONTROLLI FINANCIAR, RIKUPERIMI DHE MASAT E TJERA KUNDËR MASHTRIMIT

1. Kontrollet dhe masat kundër mashtrimit nga Bashkimi Evropian

1) Në përputhje me rregulloren financiare të zbatueshme për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian dhe me rregullat e tjera të përmendura në këtë Marrëveshje, kontratat dhe marrëveshjet e grantit të lidhura me kontraktuesit dhe përfituesit e Programeve, të vendosura në Shqipëri do të parashikojnë auditime të tjera që do të kryhen në çdo kohë nga agjentët e Komisionit ose nga persona të tjerë të autorizuar nga Komisioni gjatë zbatimit të kontratës ose marrëveshjes së grantit dhe për një periudhë pesëvjeçare, duke filluar nga data e pagesës së pjesës së mbetur. Këto auditime financiare ose auditime të tjera kryhen në ambientet e kontraktuesve dhe nënkontraktuesve të tyre dhe në ambientet e përfituesve dhe kontraktuesve dhe nënkontraktuesve të tyre.

2) Agjentët e Komisionit dhe personat e tjerë të autorizuar nga Komisioni do të kenë aksesin e duhur në vendet e punës, punët dhe dokumentet dhe në të gjitha informacionet e nevojshme, me qëllim kryerjen e auditimeve të tilla, duke përfshirë dhe formën elektronike. Kjo e drejtë aksesi do të shprehet qartë në kontratat dhe marrëveshjet e grantit të lidhura për të zbatuar instrumentet e përmendura në këtë Marrëveshje. Gjykata Evropiane e Auditëve do të ketë të njëjta të drejta si Komisioni.

3) Brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, Komisioni (OLAF) mund të kryejë hetime, duke përfshirë kontrollet në terren dhe inspektimet në territorin e Shqipërisë, në përputhje me dispozitat dhe kushtet e vendosura në Rregulloren e Këshillit (Euratom, EC) nr. 2185/96[3] dhe në Rregulloren (BE, Euratom) nr. 883/2013[4] të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, me qëllim që të përcaktohet nëse ka pasur mashtrim, korrupsion apo ndonjë aktivitet tjetër të paligjshëm që ndikon tek interesat financiare të Bashkimit Evropian dhe/ose të Euratom.

4) Këto kontrolle dhe inspektime do të përgatiten dhe do të kryhen në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet kompetente të Shqipërisë, të cilat do të njoftohen në kohën e duhur për objektin, qëllimin dhe bazën ligjore të kontrolleve dhe inspektimeve, në mënyrë që të sigurojnë të gjithë ndihmën e nevojshme.

5) Nëse autoritetet shqiptare të përfshira dëshirojnë, kontrollet në terren dhe inspektimet mund të kryhen bashkë me to.

6) Nëse pjesëmarrësit në Programe i rezistojnë kontrollit në terren ose inspektimit, autoritetet shqiptare, duke vepruar në përputhje me rregullat kombëtare, do t'u japin inspektorëve të Komisionit/OLAF-it, mbështetjen e nevojshme për t'i lejuar që të kryejnë detyrën e tyre në realizimin e kontrollit në terren ose inspektimit.

7) Komisioni/OLAF-it do t'i raportojë sa më shpejt që të jetë e mundur autoriteteve të Shqipërisë çdo fakt ose dyshim në lidhje me një parregullsi të evidentuar gjatë kontrollit në terren ose inspektimit. Në çdo rast, Komisionit/OLAF-it i kërkohet të informojë autoritetin e sipër-përmendur për rezultatin e këtyre kontrolleve dhe inspektimeve.

2. Informacionet dhe konsultimi

[3] FZ L 292, 15.1.1996, f. 2.
[4] FZ L 248, 18.9.2013, f. 1.

1) Për qëllime të zbatimit të përshtatshëm të kësaj shtojce, autoritetet kompetente të Shqipërisë dhe të BE-së do të shkëmbejnë rregullisht informacione dhe me kërkesë të njërës prej palëve, do të kryejnë konsultime.

2) Autoritetet kompetente të Shqipërisë do të informojnë Komisonin pa vonesë për çdo fakt ose dyshim që është sjellë në vëmendje të tyre në lidhje me një parregullsi mbi përfundimin dhe zbatimin e kontratave të lidhura në zbatim të instrumenteve të përmendura në këtë Marrë-veshje.

3. Masat administrative dhe gjobat

Pa cenuar zbatimin e ligjit penal të Shqipërisë, masat administrative dhe gjobat mund të vendosen nga Komisioni në përputhje me rregu-lloren financiare të zbatueshme për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian.

4. Rikuperimi

Vendimet e marra nga Komisioni brenda qëllimit të kësaj Marrëveshjeje të cilat caktojnë një detyrim financiar mbi persona të ndryshëm nga shtetet do të jenë të ekzekutueshme në Shqipëri.

Ekzekutimi do të rregullohet nga rregullat e procedurës civile në fuqi në shtetin në territorin e të cilit kryhet. Urdhri për ekzekutimin e tij i bashkëlidhet vendimit, pa formalitete të tjera, përveç verifikimit të autenticitetit të vendimit, nga autoriteti kombëtar që qeveria e Shqipërisë do të caktojë për këtë qëllim dhe do t'ia bëjë të ditur Komisionit.

Kur këto formalitete kanë përfunduar me kërkesë të Komisionit, ky i fundit vazhdon me ekzekutimin në përputhje me ligjin kombëtar, duke e sjellë çështjen drejtpërdrejt para autoritetit kompetent. Ligjshmëria e vendimit të Komisionit do t'i nënshtrohet kontrollit nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian.

Vendimet e dhëna nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian në pajtim me një dispozitë arbitrazhi në një kontratë dhe marrëveshje granti, brenda qëllimit të kësaj Marrëveshjeje, do të jenë të ekzekutueshme me të njëjtat kushte.

PROJEKT

MARRËVESHJE

NDËRMJET BASHKIMIT EVROPIAN DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË MBI PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E UNIONIT "KONKURRENCA E NDËRMARRJEVE DHE NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME (COSME)
(2014 - 2020)"

Komisioni Evropian, referuar më poshtë si "Komisioni", në emër të Bashkimit Evropian, nga njëra anë, dhe qeveria e Republikës së Shqipërisë, referuar më poshtë si Shqipëria,

Duke pasur parasysh se:

1. Një Marrëveshje Kuadër është nënshkruar më 22 nëntor 2004 ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë, e cila përcakton parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë[5] në programet e Unionit. Neni 5 i Marrëveshjes Kuadër parashikon se termat dhe kushtet specifikë, duke përfshirë kontributin financiar në lidhje me pjesëmarrjen e Shqipërisë në secilin Program të veçantë, do të përcaktohen nga Komisioni dhe Qeveria e Shqipërisë;

2. Programi për Konkurrencën e Ndër-marrjeve dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME) është krijuar me Rregulloren (BE) nr. 1287/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 11 dhjetor 2013[6];

3. Sipas nenit 6 b) të Rregullores (BE) nr. 1287/2013, vendet aderuese, vendet kandidate dhe kandidatët potencialë mund të marrin pjesë në përputhje me parimet e përgjithshme dhe termat dhe

[5] FZ L 192, 22.7.2005, f. 2.

[6] FZ L 347, 20.12.2012, f. 33.

kushtet e përgjithshëm për pjesëmarrjen e atyre vendeve në programet e Unionit të krijuara në Marrëveshjet përkatëse Kuadër dhe vendimet e Këshillit të Shoqatës ose marrëveshjeve të ngjashme;

4. Organet e vendosura në Shqipëri do të kenë të drejtën të marrin pjesë në aktivitetet periodike, të cilat duhet të fillojnë para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Si rrjedhojë, kostot e shpenzuara për këto aktivitete, zbatimi i të cilave fillon në 2014-n, do të konsiderohen të pranueshme sipas të njëjtave kushteve si ato që zbatohen për kostot e shpenzuara nga organet e vendosura në shtetet anëtare, me kusht që kjo marrëveshje të hyjë në fuqi para përfundimit të veprimit në fjalë,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Programi

Shqipëria do të marrë pjesë në Programin për Konkurrencën e Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (referuar më poshtë si "Programi"), në përputhje me kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen Kuadër të datës 22 nëntor 2004, ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë, mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programet e Unionit, dhe sipas termave dhe kushteve të përmendur në këtë Marrëveshje.

Neni 2

Termat dhe kushtet në lidhje me pjesëmarrjen në Program

1. Shqipëria do të marrë pjesë në aktivitetet e Programit në përputhje me objektivat, kriteret, procedurat dhe afatet e përcaktuara në Rregulloren (BE) nr. 1287/2013, dhe si më poshtë:

2. Termat dhe kushtet e zbatueshëm për paraqitjen, vlerësimin dhe përzgjedhjen e aplikimeve dhe për zbatimin e veprimeve nga institucionet e ligjshme, organizatat dhe individët e pranueshëm të Shqipërisë do të jenë të njëjta me ato të zbatuara për institucionet, organizatat dhe individët e pranueshëm të Shteteve Anëtare.

3. Për të marrë pjesë në Program, Shqipëria do të paguajë çdo vit një kontribut financiar për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian në përputhje me nenin 3 më poshtë.

4. Kontributi financiar i Shqipërisë në lidhje me pjesëmarrjen e saj dhe zbatimin e programit do t'i shtohet shumës së rezervuar çdo vit në Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian për kostot totale të autorizuara të detyrimeve të pranueshme, në mënyrë që të përmbushen detyrimet financiare që rrjedhin nga forma të ndryshme të masave të nevojshme për ekzekutimin, menaxhimin dhe operimin e programit.

5. Një nga gjuhët zyrtare të BE-së, në këtë rast gjuha angleze, do të përdoret për procedurat në lidhje me kërkesat, kontratat dhe raportet, si dhe për aspekte të tjera administrative të Programit.

Neni 3

Kontributi Financiar

Rregullat që rregullojnë kontributin financiar të Shqipërisë përcaktohen në shtojcën I.

Neni 4

Raportimi dhe vlerësimi

Pa cenuar përgjegjësitë e Komisionit dhe Gjykatës Evropiane të Auditëve në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e programit, pjesëmarrja e Shqipërisë në Program do të monitorohet vazhdimisht mbi një bazë partneriteti, ndërmjet Komisionin dhe Shqipërisë. Shqipëria do t'i dërgojë Komisionit raportet përkatëse dhe do të marrë pjesë në aktivitete të tjera specifike të parashikuara nga BE-ja në këtë kontekst.

Raportimi dhe vlerësimi do të kryhen në përputhje me rregullat e përcaktuara në shtojcën II.

Neni 5

Dispozita të fundit

1. Kjo Marrëveshje do të zbatohet për kohëzgjatjen e Programit, duke filluar nga 1 janari 2014. Megjithatë, nëse Bashkimi Evropian vendos të zgjasë kohëzgjatjen pa ndonjë ndryshim thelbësor brenda Programit, kjo Marrëveshje do të zgjatet përkatësisht dhe automatikisht nëse asnjëra palë nuk e kundërshton brenda një muaji pas vendimit të zgjatjes së afatit.

2. Kjo Marrëveshje mund të përfundohet nga Palët në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së Programit me një njoftim me shkrim me anë të të cilit informon mbi qëllimin për të përfunduar pjesëmarrjen në Program. Në bazë të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, përfundimi do të hyjë në fuqi tre muaj kalendarikë pas datës kur njoftimi me shkrim arrin te marrësi.

3. Projektet dhe aktivitetet në proces në kohën e përfundimit do të vazhdojnë deri në përfundimin e tyre sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, si dhe marrëveshjeve kontraktuale që zbatohen për këto projekte dhe aktivitete dhe dispozitave të shtojcës II.

4. Shtojcat formojnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

5. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me shkrim me pëlqimin e ndërsjellë të palëve.

Neni 6

Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën në të cilën Shqipëria njofton Komisionin, nëpërmjet kanaleve diplomatike, se ratifikimi i saj i brendshëm ka përfunduar.

Bërë në:
Për Republikën e Shqipërisë:
Ministër i Republikës së Shqipërisë

Për Komisionin Evropian:
Në emër të Bashkimit Evropian:
A. Tajani
Zëvendëspresident i Komisionit

SHTOJCA I

RREGULLAT QË RREGULLOJNË KONTRIBUTIN FINANCIAR TË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E UNIONIT "KONKURRENCA E NDËRMARRJEVE DHE NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME (COSME)

1. Llogaritja e kontributit financiar të Shqipërisë

1) Kontributi financiar për t'u paguar nga Shqipëria për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian për të marrë pjesë në Program do të vendoset në raport me shpërndarjen vjetore në Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian për kostot totale të autorizuara të detyrimeve të pranueshme, të nevojshme për zbatimin, mena-xhimin dhe operimin e Programit.

2) Kontributi financiar do të llogaritet duke aplikuar faktorin e proporcionalitetit në buxhetin mesatar vjetor të Programit.

3) Faktori i proporcionalitetit që rregullon kontributin e Shqipërisë është marrë nga vendosja e një raporti ndërmjet produktit të brendshëm bruto të Shqipërisë me çmimet e tregut, dhe shuma e produkteve të brendshme bruto me çmimet e tregut të Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë.

(GDP me çmimet e tregut për Shqipërinë) /(GDP me çmimet e tregut për BE-në 28+ Shqipëria) = faktori i proporcionalitetit
(Faktori i proporcionalitetit) x buxheti mesatar vjetor i Programit = kontributi financiar i Shqipërisë për COSME-n.
Buxheti mesatar vjetor = buxheti shumëvjeçar i miratuar me Rregulloren (BE) 1287/2013 (2298.243 mil € / 7 = (328.32 mil €)

4) Ky raport është llogaritur mbi bazën e të dhënave të fundit statistikore që i përkasin të njëjtit vit nga Zyra Statistikore e Komuniteteve Evropiane (Eurostat), në dispozicion në kohën e negocimit të kësaj Marrëveshjeje.

5) Kjo shtojcë përfshin shumat fikse për katër vitet e para të zbatimit të Programit (2014 - 2017).

6) Për pjesën e mbetur të Programit (2018 - 2020), kontributi financiar vjetor do të llogaritet gjatë vitit 2017, duke përdorur të njëjtën formulë, duke marrë parasysh të dhënat e fundit statistikore dhe çdo ndryshim në buxhetin total të Programit.

7) Kontributet financiare vjetore për t'u paguar nga Shqipëria për buxhetin e Bashkimit Evropian për të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e Programit për periudhën 2014 - 2017 do të jenë si më poshtë: € 235.838.

8) Kontributi i Shqipërisë do të mbulojë kostot e lidhura me zhvillimin dhe ekzekutimin e veprimeve të parashikuara në Program.

9) Kostot e udhëtimit dhe kostot e jetesës të shkaktuara nga përfaqësuesit dhe ekspertët e Shqipërisë për qëllime të marrjes pjesë si vëzhgues në punën e Komitetit të përmendur në nenin 21 të Rregullores (BE) 1287/2013, që krijon Konkurrencën e Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (COSME) (Komiteti i Menaxhimit të COSME-s) ose takime të tjera në lidhje me zbatimin e Programit, do të rimbursohen nga Komisioni mbi të njëjtën bazë dhe në përputhje me procedurat aktualisht në fuqi për përfaqësuesit e Shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

10) Rregullorja Financiare e zbatueshme për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian do të zbatohet për menaxhimin e kontributit të Shqipërisë.

2. Pagesa e kontributit financiar të Shqipërisë

1) Pasi kjo Marrëveshje të jetë ratifikuar dhe në fillim të çdo viti vijues buxhetor, Komisioni do t'i dërgojë Shqipërisë një thirrje për fondet që i korrespondojnë kontributit të saj për kostot e mbuluara nga kjo Marrëveshje.

2) Ky kontribut do të paguhet në euro në një llogari bankare të caktuar në euro të Komisionit.

3) Shqipëria do të paguajë kontributin e saj për kostot vjetore në përputhje me thirrjen për fonde jo më vonë se tre muaj pas datës së thirrjes. Çdo vonesë në pagesën e kontributit do të shkaktojë pagesën e interesit të munguar nga Shqipëria mbi shumën e papaguar që nga data e caktuar. Norma e interesit do të jetë norma e zbatuar nga Banka Qendrore Evropiane për operacionet e saj kryesore të rifinancimit, siç publikohet në seritë C të Fletores Zyrtare të Bashkimit Evropian, në fuqi në ditën e parë kalendarike të muajit në të cilin bie afati, rritur me 3.5 pikë për qind.

Në rast se vonesa në pagesën e kontributit është e tillë që mund të rrezikojë seriozisht zbatimin dhe menaxhimin e Programit, dhe rast mospagese, 20 ditë pune pas një letre zyrtare kujtese të dërguar nga Komisioni për Shqipërinë, pjesëmarrja e Shqipërisë në Program për vitin përkatës do të pezullohet.

SHTOJCA II

KONTROLLI FINANCIAR, RIKUPERIMI DHE MASAT E TJERA KUNDËR MASHTRIMIT

1. Kontrollet dhe masat kundër mashtrimit nga Bashkimi Evropian

1) Në përputhje me rregulloren financiare të zbatueshme për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian dhe rregullat e tjera të përmendura në këtë Marrëveshje, kontratat dhe marrëveshjet e grantit të lidhura me kontraktuesit dhe përfituesit e Programeve të vendosura në Shqipëri, do të parashikojnë auditime të tjera që do të kryhen në çdo kohë nga agjentët e Komisionit ose nga persona të tjerë të autorizuar nga Komisioni gjatë zbatimit të kontratës ose marrëveshjes së grantit dhe për një periudhë pesëvjeçare, duke filluar nga data e pagesës së pjesës së mbetur. Këto auditime financiare ose auditime të tjera kryhen në ambientet e kontraktuesve dhe nënkontraktuesve të tyre dhe në ambientet e përfituesve dhe kontraktuesve dhe nënkontraktuesve të tyre.

2) Agjentët e Komisionit dhe personat e tjerë të autorizuar nga Komisioni do të kenë aksesin e duhur në vendet e punës, punët dhe dokumentet dhe në të gjitha informacionet e nevojshme, me qëllim kryerjen e auditimeve të tilla, duke përfshirë dhe formën elektronike. Kjo e drejtë aksesi do të shprehet qartë në kontratat dhe marrëveshjet e grantit të lidhura për të zbatuar instrumentet e përmendura në këtë Marrëveshje. Gjykata Evropiane e Auditëve do të ketë të njëjta të drejta si Komisioni.

3) Brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, Komisioni (OLAF) mund të kryejë hetime, duke përfshirë kontrollet në terren dhe inspektimet në territorin e Shqipërisë, në përputhje me dispozitat dhe kushtet e vendosura në Rregulloren e Këshillit (Euratom, EC) nr. 2185/96[7] dhe në Rregulloren (BE, Euratom) nr. 883/2013[8] të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, me qëllim që të përcaktohet nëse ka pasur mashtrim, korrupsion apo ndonjë aktivitet tjetër të paligjshëm që ndikon tek interesat financiare të Bashkimit Evropian dhe/ose të Euratom.

4) Këto kontrolle dhe inspektime do të përgatiten dhe do të kryhen në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet kompetente të Shqipërisë, të cilat do të njoftohen në kohën e duhur për objektin, qëllimin dhe bazën ligjore të kontrolleve dhe të inspektimeve, në mënyrë që të sigurojnë të gjithë ndihmën e nevojshme.

5) Nëse autoritetet shqiptare të përfshira dëshirojnë, kontrollet në terren dhe inspektimet mund të kryhen bashkë me to.

6) Nëse pjesëmarrësit në Programe i rezistojnë kontrollit në terren ose inspektimit, autoritetet shqiptare, duke vepruar në përputhje me rregullat kombëtare, do t'u japin inspektorëve të Komisionit/OLAF-it mbështetjen e nevojshme për t'i lejuar që të kryejnë detyrën e tyre në realizimin e kontrollit në terren ose inspektimit.

7) Komisioni/OLAF-i do t'u raportojë sa më shpejt që të jetë e mundur autoriteteve të Shqipërisë çdo fakt ose dyshim në lidhje me një parregullsi të evidentuar gjatë kontrollit në terren ose inspektimit. Në çdo rast, Komisionit /OLAF-it i kërkohet të informojë autoritetin e sipërpërmendur për rezultatin e këtyre kontrolleve dhe inspektimeve.

2. Informacionet dhe konsultimi

1) Për qëllime të zbatimit të përshtatshëm të kësaj shtojce, autoritetet kompetente të Shqipërisë dhe të BE-së do të shkëmbejnë rregullisht informacione, dhe me kërkesë të njërës prej palëve, do të kryejnë konsultime.

2) Autoritetet kompetente të Shqipërisë do të informojnë Komisonin pa vonesë për çdo fakt ose dyshim që është sjellë në vëmendje të tyre në lidhje me një parregullsi mbi përfundimin dhe zbatimin e kontratave të lidhura në zbatim të instrumenteve të përmendura në këtë Marrëveshje.

[7] FZ L 292, 15.1.1996, f. 2.
[8] FZ L 248, 18.9.2013, f. 1.

3. Masat administrative dhe gjobat

Pa cenuar zbatimin e ligjit penal të Shqipërisë, masat administrative dhe gjobat mund të vendosen nga Komisioni në përputhje me rregulloren financiare të zbatueshme për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian.

4. Rikuperimi

Vendimet e marra nga Komisioni brenda qëllimit të kësaj Marrëveshjeje, të cilat caktojnë një detyrim financiar mbi personat e ndryshëm nga shtetet, do të jenë të ekzekutueshme në Shqipëri.

Ekzekutimi do të rregullohet nga rregullat e procedurës civile në fuqi në shtetin në territorin e të cilit kryhet. Urdhri për ekzekutimin e tij i bashkëlidhet vendimit, pa formalitete të tjera, përveç verifikimit të autenticitetit të vendimit, nga autoriteti kombëtar që Qeveria e Shqipërisë do të caktojë për këtë qëllim dhe do t'ia bëjë të ditur Komisionit.

Kur këto formalitete kanë përfunduar me kërkesë të Komisionit, ky i fundit vazhdon me ekzekutimin në përputhje me ligjin kombëtar, duke e sjellë çështjen drejtpërdrejt para autoritetit kompetent. Ligjshmëria e vendimit të Komisionit do t'i nënshtrohet kontrollit nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian.

Vendimet e dhëna nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian në pajtim me një dispozitë arbitrazhi në një kontratë dhe marrëveshje granti brenda qëllimit të kësaj Marrëveshjeje, do të jenë të ekzekutueshme me të njëjtat kushte.